


Rruga "Dora D'istria", Nr.10,
P.O. Box 8363, Tiranë,
+355 4 22 28 260

www.amf.gov.al

Sigurimi i Pronës



AMF 045254-8732-
218292-57843294212
42714-388326555-3
9-4-5734-85
A 5-34
-5734-85
-36732-34
-57843-88
-36732-34
21-12
42732-10-2-05
AMF 92-578432-895
23519421238-21731

amf

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Përmbajtja

1. Cilat janë palët e përfshira në kontratat e sigurimit të pronës?
2. Cilat janë llojet kryesore të kontratave të sigurimit të pronës dhe rreziqet e mbuluara prej tyre?
3. Të drejtat dhe detyrimet e të siguarit në kontratën e sigurimit të pronës
4. Të drejtat dhe detyrimet e siguruesit në kontratën e sigurimit të pronës
5. Si të vlerësoni përshtatshmërinë e kontratës së ofruar?
6. E drejta për informim
7. Kur konsiderohet e lidhur kontrata e sigurimit të pronës?
8. Primi dhe shuma e sigurimit
9. Çfarë duhet të bëni për të ndryshuar, anuluar apo përfunduar përpara afatit një kontratë të sigurimit të pronës?
10. Kërkesa për dëmshpërblim
11. Si mund të bëni një ankesë
12. Legjislacioni i zbatueshëm



Sigurimi i Pronës

Ky material informues ka për qëllim t'i shërbejë konsumatorit si një udhëzues, për t'i ndihmuar të kenë më tepër informacion përpara se të vendosin për të marrë një kontratë sigurimi të pronës. Materiali jep informacion edhe mbi të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit.

1. Cilat janë palët e përfshira në kontratat e sigurimit të pronës?

I siguruari është personi i cili siguron pasurinë e tij, duke paguar primin e sigurimit dhe ka të drejtë të dëmshpërblehet nga siguruesi, në rast se vërtetohet ngjarja e sigurimit e parashikuar në kontratë.



Siguruesi është shoqëria e sigurimit e cila merr përsipër të bëjë sigurimin e pronës së të siguarit kundrejt pagesës së primit. Ai paguan dëmshpërblimin në favor të të siguarit ose në favor të personit të tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, në rast se ndodh ngjarja e sigurimit.

Përfituesi (Personi i tretë) është pala e cila pavarësisht faktit nëse ekziston apo jo në momentin e lidhjes së kontratës, fiton të drejtën që të marrë nga siguruesi, dëmshpërblimin e përcaktuar në kontratë.

2. Cilat janë llojet kryesore të kontratave të sigurimit të pronës dhe përse shërbejnë ato?

- Sigurimi nga zjarri dhe rreziqet shtesë siguron pronën nga humbjet, dëmtimet ose shkatërrimet në mënyrë të papritur, të paparashikuar dhe aksidentale si pasojë e zjarrit, tërmetit, përmbytjet, rrufesë, stuhisë, etj.
- Sigurimi nga vjedhja garanton dëmshpërblim për sendet e vjedhura të listuara në kontratën e sigurimit.
- Sigurimi i kulturave bujqësore siguron të gjitha llojet e kulturave ndaj breshërit dhe rreziqeve natyrore si: stuhia, përmbytja, ngrica apo shtrëngata.
- Sigurimi i blegtorisë është një kontratë sigurimi, me anë të së cilës sigurohet blegtoria ndaj sëmundjeve dhe aksidenteve.
- Sigurimi i ndërprerjes së biznesit mbulon shpenzimet si pasojë e ndërprerjes së aktivitetit të biznesit nga zjarri apo rreziqet shtesë, duke garantuar fitimin neto si dhe kostot fikse.



3. Të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit në kontratën e sigurimit të pronës

- ❖ I siguruari përpara lidhjes së kontratës, si edhe gjatë periudhës së mbulimit duhet të njoftojë siguruesin për çdo rrethanë për të cilat ai ka dijeni dhe që ndikon në përcaktimin e primit të sigurimit, ose shtimin e rrezikut të sigurimit.
- ❖ I Siguruari ka detyrimin që të paguajë në favor të siguruesit primin e parashikuar në kontratë.
- ❖ I siguruari, me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, duhet të njoftojë siguruesin brenda afatit të përcaktuar në kontratë.
- ❖ I Siguruari ka detyrimin që gjatë vazhdimit të kontratës së sigurimit, të ruajë me kujdes pasurinë e siguar.



4. Të drejtat dhe detyrimet e siguruesit në kontratën e sigurimit të pronës

- ❖ Siguruesi ka detyrimin të paguajë në favor të të siguruarit dëmshpërblimin e sigurimit vetëm brenda vlerës së përcaktuar në kontratë.
- ❖ Siguruesi ka të drejtë t'i kërkojë kthimin e shumës së paguar, personave përgjegjës për shkaktimin e dëmit.
- ❖ Siguruesi ka të drejtë të mos dëmshpërblejë, në rast se ngjarja e sigurimit është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e të siguruarit ose raste të tjera përjashtimore të parashikuara në kontratë.





5. Si të vlerësoni përshtatshmërinë e kontratës së ofruar?

Për të lidhur një kontratë sigurimi duhet të drejtoheni tek një ndërmjetës në sigurime (agjent apo broker) ose tek punonjësi i shoqërisë së sigurimit. Në këtë rast, duhet:

- a) Të kërkonti t'ju shpjegohen karakteristikat kryesore të kontratës për produktet të cilat i ofron shoqëria e sigurimit;
- b) Të jepni informacion mbi nevojat tuaja për sigurim;
- c) Të prezantoni gjendjen tuaj financiare;
- d) Të jepni informacion mbi masën e rrezikut që jeni të gatshëm të merrni përsipër dhe mbi qëllimet që dëshironi të arrini.



Kjo do të lejojë që së bashku me ndërmjetësin në sigurime, të identifikohen nevojat e individit i cili kërkon të sigurohet për të kërkuar tek shoqëria e sigurimit produktin që përshtatet më shumë me këto nevoja.

6. E drejta për informim



Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit në sigurime detyrohen t'i ofrojnë çdo individ të interesuar përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit të pronës, të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me llojin e sigurimit. Ky informacion gjendet edhe në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë dhe duhet të jetë:

- i plotë
- i saktë
- i qartë
- lehtësisht I aksesueshëm

Konsultoni faqet *online* të shoqërive të sigurimit, të cilat ofrojnë sigurimin e pronës apo pyesni punonjësin e shoqërisë ose ndërmjetësin për të marrë informacionin që Ju nevojitet.

Gjithashtu, shoqëria e sigurimit merr informacion nga ju nëpërmjet plotësimit të formularit për të përcaktuar nivelin e rrezikut dhe primin e sigurimit.



7. Kur konsiderohet e lidhur kontrata e sigurimit të pronës?

Kontrata e sigurimit të pronës konsiderohet e lidhur dhe prodhon efektet e saj, kur:

- a) Është nënshkruar policia e sigurimit nga të dy palët, dhe
- b) Është paguar primi apo kësti i parë i tij, sipas përcaktimeve në kontratë.



Kujdesuni të merrni një kopje origjinale të policës dhe verifikoni që dokumenti nuk përmban korrigjime. Polica e sigurimit është dokumenti që vërteton që ju keni një sigurim të vlefshëm të pronës.

8. Primi dhe shuma e sigurimit (1)

Primi që paguan i siguruari përcaktohet në kontratën e sigurimit. Në përcaktimin e primit shoqëria e sigurimit mban në konsideratë riskun që mbart çdo i siguar, shpenzimet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit, marzhin e pritshëm të fitimit si dhe taksat e mundshme që mund të aplikohen në periudhën e nënshkrimit të kontratës së sigurimit.



Shoqëria e sigurimit mund të aplikojë dhe pjesën e zbritshme, e cila nga njëra anë ndikon në uljen e primit të paguar nga i siguruari dhe nga ana tjetër, në rastet e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, siguruesi zbret nga vlera e dëmshpërblimit pjesën e zbritshme të përcaktuar në kontratë.



8. Primi dhe shuma e sigurimit (2)

Shuma e sigurimit përcaktohet në kontratën e sigurimit dhe përfaqëson vlerën maksimale të dëmshpërblimit në rast të ndodhjes së ngjarjes së siguruar. Sugjerohet që prona të sigurohet në vlerën e plotë të zëvendësimit të objektit, duke përfshirë gjithashtu dhe shpenzimet e nevojshme për të kthyer pronën në gjendjen e mëparshme.

Nëse shuma e siguruar tejkalon ndjeshëm vlerën e siguruar atëherë si siguroesi ashtu edhe i siguruari mund të kërkojnë zvogëlimin e shumës së siguruar dhe primi i paguar do të zvogëlohet respektivisht.

Nëse para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, shuma e siguruar është më e vogël se vlera e sigurimit, atëherë dëmshpërblimi do të shumëzohet me koeficientin e nënsigurimit, i cili përcaktohet si raport i shumës së siguruar ndaj vlerës së sigurimit.



Pagesa e primit mund të kryhet në disa forma, në varësi të kontratës së sigurimit:

- Me këste;
- Për të gjithë periudhën.



Pagesa e primit mund të kryhet nëpërmjet sistemit bankar dhe/ose para në dorë. Si dëshmi e pagesës së primit mund të jetë, dokumenti bankar i pagesës apo mandati i arkëtimit i lëshuar nga shoqëria e sigurimit me përshkrimin e pagesës së kryer.

9. Çfarë duhet të bëni për të ndryshuar, anuluar apo përfunduar përpara afatit një kontratë të sigurimit të pronës?

Kontrata e sigurimit të pronës mund të ndryshojë, anulohet apo të përfundojë përpara afatit, në varësi të ndryshimit të rrethanave bazuar në të cilat është lidhur.



Në kontratat e sigurimit të pronës përcaktohen mënyrat për ndryshimin, anulimin apo përfundimin përpara afatit. Prandaj është shumë e rëndësishme të lexoni me kujdes kushtet e kontratës, përpara se ta firmosni atë, edhe pse në momentin e firmosjes së kontratës ju nuk mendoni ta ndryshoni, anuloni apo përfundoni përpara afatit.

10. Kërkesa për dëmshpërblim

I siguruari raporton dëmin dhe kërkon dëmshpërblimin për humbjet apo dëmtimet e pësuar të pronës që ka siguruar brenda afatit ligjor të përcaktuar në kontratë. Procedura për dëmshpërblim bëhet sipas formularit të publikuar në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë së sigurimit dhe shoqërohet nga të paktën këto dokumenta:

- Kërkesë për dëmshpërblim e plotësuar me detaje për ngjarjen e ndodhur;
- Konfirmimin dhe /ose vendimin e organeve kompetente shtetërore mbi shkakun dhe/ose shkaktarët e dëmtimit të pronës;
- Polica origjinale e sigurimit për pronën e dëmtuar, shoqëruar me kontratën dhe pyetësozin e marrjes në sigurim;
- Karta e identitetit e aplikuesit për dëmshpërblim;
- Autorizim përfaqësimi nga pronari i ligjshëm, kur aplikuesi është dikush tjetër;
- Foto/video të pronës së dëmtuar në tërësi dhe çdo element të pretenduar për dëmshpërblim në veçanti në vendngjarje;
- Certifikata e pronësisë së objektit të dëmtuar;
- Skica, projekti, gjenplani i pronës, objektit të dëmtuar, librezë teknike e pajisjes së dëmtuar;
- Listë e detajuar e pajisjeve ose objekteve të dëmtuara në këtë ngjarje;
- Deklaratë nga dëshmitarët në vendngjarje;
- Akt vlerësimi i dëmit nga vlerësues të licencuar.
- Relacion përmbledhës mbi ngjarjen e ndodhur dhe vlerësimin e dëmit.

Në faqen zyrtare online: www.amf.gov.al, AMF ka publikuar listën e ndërmjetësve të licencuar/autorizuar për të kryer shërbime ndërmjetësimi.



11. Si mund të bëni një ankesë



Nëse keni pakënaqësi apo mendoni që shoqëria e sigurimit nuk i përmbahet kushteve të kontratës, ju mund të bëni një ankesë.

Për të marrë më tepër informacion jeni të lutur të konsultoheni me materialin informues për ankesat, të publikuar nga Autoriteti, i cili gjendet në www.amf.gov.al

12. Legjislacioni i zbatueshëm

Kontratat e sigurimit rregullohen nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (Kreu XXIII – Sigurimi), Ligji nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Jini të kujdesshëm, lexoni dhe merrni informacionin dhe sqarimet e nevojshme për të kuptuar kontratën e sigurimit përpara se ta nënshkruani atë, në të kundërt mund të rrezikoni të zgjidhni një kontratë që mund të jetë e papërshtatshme për nevojat tuaja aktuale për sigurimin e pronës apo që nuk janë në përputhje me nevojat tuaja.



Duhet të keni parasysh se është në interesin tuaj të krahasoni propozimet nga shoqëri të ndryshme të cilat operojnë në tregun e sigurimit të Jo-Jetës në vend, për të garantuar një zgjedhje të informuar.